



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 16.06.2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. BEKIM MORINA** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Rexhep Kurtbogaj.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Bekim Morina dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

## Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 11.06.2020, Nr.562/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Rexhep Kurtbogaj, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të emërimit në pozitën e Drejtorit për Administratë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur i cila është, z. Bekim Morina ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 16.06.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

